



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5 dhe 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr.9/2013 për Votim, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit, si dhe nenin 3 germa (a) dhe (b) të Rregullës Zgjedhore 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjet e rregullt të mbajtur me 14.02.2020, nxjerr këtë:

## UDHËZIM

### Për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për Zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës 2020

- I. Udhëzohet Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV) të cilat merren me organizimin dhe me implementimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, që ditën e zgjedhjeve, me 15 mars 2020, t'i pranojë në vendvotim dokumentet e identifikimit të votuesve siç janë:
  - a. leternjoftim i vlefshëm i Kosovës;
  - b. pasaport valide;
  - c. dokument i vlefshëm i udhëtimit;
  - d. leje e vozitjes e vlefshme e Kosovës;
- II. Dokument i vlefshëm i votimit konsiderohen të gjitha dokumentet e Republikës së Kosovës, siç i parasheh neni 90 i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Përgjithshme.
- III. Ky Udhëzim është i obligueshëm për KKZ-në dhe KVV-të, në Komunën e Podujevës.
- IV. Kontakti për informata shtesë apo sqarime shtesë lidhur me këtë udhëzim është :  
**Nr. Tel : 0800 55 555**
- V. Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe iu dërgohet trupave zgjedhore menjëherë.

Prishtinë, 14.02.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Prishtina  
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA